

AKT I THEMELUES

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ALBA BETON" Sh.p.k.



E lidhur sot me daten 18 shtator 1996 (nentedhjete e gjashte), ne TIRANE ndermjet paleve te pranishme si me poshte :

1 - Zotit GIOVANNI TELESCA, shtetas italian, i datelindjes 29.03.1954, lindur ne Potenza dhe banues po aty ne adresen "Via Poggio Cavallo nr. 124", me Pasaporte nr. 258648K,

dhe

2 - Zotit ITALO GIGANTE, shtetas italian, i datelindjes 19.12.1913, banues ne Italy, me Pasaporte nr. 389615C.

Personat e mesiperm, ketu me poshte ne kete AKT THEMELUES te quajtur bashkerisht ose vecmas "ORTAKE", kane rene dakort si me poshte :

Neni 1 - EMERTIMI, QENDRA DHE AFATI I SHOQERISE

ORTAKET, me marreveshje unanime midis tyre themelojne nje shoqeri ORTAKET, me pergjegjesi te kufizuar te se drejtes shqiptare (e cila me poshte do te quhet "SHOQERIA". Percaktimet e hollesishme ne lidhje me qellimet dhe objektin e veprimitarise se SHOQERISE, menyren dhe rregullat per funksionimin e saj tregohen me te plota dhe te lidhura me poshte ne kete AKT THEMELUES si edhe ne STATUTIN bashkengjitur.

Emertimi i SHOQERISE do te jetë : "ALBA BETON" Sh.p.k.

Qendra (selia) legale e SHOQERISE eshte ne qytetin e TIRANES ne adresen : Rr."Arkitkt Sinani", Lagja 15, Pall 220/1, nr 7. Tirane.

SHOQERIA, me vendim te organeve te saj, mund te themeloje ose anulloje seli sekondare, filiale, perfaqesi, dege dhe agjensi te saj qofte edhe ne shtete te tjera.

Kohozgjatja e SHOQERISE fillon diten e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar dhe mbaron me diten e 31 (tridhjete e nje) Dhjetorit te vitit 2020 (dymije e njezet). Asamblea e Ortakeve ne perputhje me menyren dhe proceduren e percaktuar ne dispozitat e STATUTIT te SHOQERISE mund te zgjate ose te vendose mbarimin e parakohshem te SHOQERISE.

Neni 2 - NATYRA JURIDIKE DHE TREGTARE E SHOQERISE

SHOQERIA eshte person juridik privat i se drejtes shqiptare, veprimitaria e se ciles rregullohet nga ky AKT THEMELUES, STATUTI i saj bashkelidhur dhe legjislativni shqiptar.

*Tefeqi teku  
Italo Gigante*

asistences dhe konsulences teknike, ligjore dhe te menaxhimit te veprimtarive te cdo lloji dhe ne vecanti ne fushat te cilat kane lidhje me objektin e veprimtarise se SHOQERISE.

3.5. SHOQERIA mund te ushtroje edhe veprimtarine e perfaqesimit, te ndermjetesimit apo te agjensise per persona fizike apo juridike, publike, shteterore apo private, vendas apo te huaj.

3.6. SHOQERIA mund te ushtroje veprimtari te tjera tregtare dhe gjithashtu, mund te jape ose te perfitoje leasing, te gjitha keto mbi pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, makineri, pajisje te cfaredo lloji dhe gjithashtu, mund te kryeje cdo lloj veprimi tjeter me pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, veprime finaciare duke perfshire ketu edhe factoring, tregtare te gjitha keto te quajtura te nevojshme dhe te dobishme per realizimin e qellimeve te objektit te veprimtarise se SHOQERISE.

3.7. SHOQERIA ka te gjitha te drejtat per te marre pjesë ne fitimet dhe /ose ne shoqeri te tjera te se drejtes shqiptare ose te shteteve te tjera dhe te themeloje shoqeri te tjera me persona fizike ose juridike, publike ose private, vendas ose te huaj.

#### Neni 4 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i SHOQERISE ne castin e themelimit te saj eshte ne Leke 100.000 (njeqindmije), shume kjo e derdhur dhe depozituar per efekt te ligjit ne degen e Tiranes te Bankes se Kursimeve.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar ne teresine e tyre nga ORTAKET dhe jane shlyer krejtesisht ne te holla me modalitetet e pjesmarrjes si vijon :

- GIOVANNI TELESCA, ka derdhur dhe shlyer shumen ne Leke 50.000.00.(pesedhjete mijë), shume kjo e barasvlefshme me 50 % (pesedhjete per qind) te kuotave te pjemarrjes ne SHOQERI, duke zoteruar kuotat me numer 1 (nje) deri 50 (pesedhjete).


- ITALO GIGANTE, ka derdhur dhe shlyer shumen ne Leke 50.000.00. (pesedhjete mijë), shume kjo e barasvlefshme me 50 % (pesedhjete per qind) te kuotave te pjesmarrjes ne SHOQERI, duke zoteruar kuotat me numer 51 (pesedhjete e nje) deri 100 (njeqind).

Vlera e cdo kuote te kapitalit themeltar eshte 1000 Leke/per Kuote.

Kapitali themeltar i SHOQERISE do te rritet nepermjet nenshkrimit dhe derdhjes se kontributeve ne te holla ose me ane te perfshirjes ne te, te vleftes se objekteve apo pasurive te paluajtshme ose te luajtshme te fituara ose qe do te fitohen ne menyra te ndryshme te ligjshme nga SHOQERIA. Vleresimi i tyre behet ne perputhje me nenin 42 te Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

ORTAKET, ne marreveshje midis tyre dhe ne perputhje me aktet e SHOQERISE, mund te vendosin rritjen ose pakesimin e vleftes se kapitalit themeltar.

*Talere Beva  
Italo Gigante*



- 5 -

#### Neni 9 - ORGANET E SHOQERISE

Organet e SHOQERISE jane :

- 1 - Asamblea e Ortakeve;
- 2 - Administratoret.

Administratore te SHOQERISE jane te dy ORTAKET e saj, zoterinje GIOVANNI TELESCA dhe ITALO GIGANTE.

Drejtori teknik i punimeve eshte z. VALBONA CICE.

Perberja, funksionet dhe kohezgjatja e organave te SHOQERISE percaktohen ne STATUTIN e saj bashkelidhur dhe pjesa perberese e ketij AKTI THEMELUES.

#### Neni 10 - FSHEHTESSA E INFORMACIONIT

ORTAKET marrin persiper reciprokisht te ruajne karakterin konfidencial te dokumentacionit, te informacionit, te te dhenave dhe pervojes se fituar gjate veprimtarise se SHOQERISE si dhe te marrin masat e nevojshme per te penguar perhapjen e tyre ne cfaredo menyre e forme.

ORTAKET pergjigjen per pasojat e demshme te shkaktuara SHOQERISE nga mosrespektimi i detyrimeve te lartpermendura.

#### Neni 11 - MOSMARRVESHJET

Ne rastin kur do te lindnin mosmarreveshje midis ORTAKEVE ose midis ORTAKEVE dhe SHOQERISE lidhur me interpretimin ose zbatimin e ketij AKTI THEMELUES, ORTAKET deklarojne se i besojne zgjidhjen e mosmarreveshjes nje koleksi arbitrash te cilet do te vendosin zgjidhjen e asaj mosmarreveshje. Arbitrat do te zgjidhen midis profesionisteve te Listes se Dhomës se Avokateve te Tiranës. Secila pale emeron nje arbiter ndersa i treti, edhe me funksionin e Kryetarit te Kolegit te Arbitrave, caktohet me konsensus nga dy arbitrat e emeruar. Vetem ne rast te mungeses se marreveshjes per caktimin e ekspertit te katert, ky i fundit do te emerohet nga Kryetari i Dhomës te Avokateve te Tiranës me kerkesen e njeres pale.

Koleksi i Arbitrave si mesiper duhet te dorezoje vendimin e zgjidhjes se mosmarreveshjes brenda tridhjete diteve nga emerimi i tyre.

Vendimi merret me shumice votash dhe pa formalitet te vecanta. Ne rast barazie votash vendos vota e Kryetarit te Kolegit te Arbitrave treguar ne paragrafin e pare te ketij nenit. Ky vendim eshte i detyrueshem per palet. Ne rast te kundert dhe mospajtimi te metejshem zgjidhja e mosmarreveshjes i paraqitet Gjykates se rrerhit Tirane.

#### Neni 12- STATUSI I AKTIT THEMELUES DHE I STATUTIT TE SHOQERISE


SHOQERIA deklarohet e themeluar dhe veprimitaria e saj e rregulluar ne perputhje me dispozitat e ketij AKTI THEMELUES dhe te STATUTIT te SHOQERISE dhe, te cilat, jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

*Taleene Leclerc  
Bjalo Gjoniu*

S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ALBA BETON" Sh.p.k.



Shoqeria Tregtare "ALBA BETON" Sh.p.k. (e cila ketu me poshte quhet "SHOQERIA") eshte themeluar ne baze te Aktit Themelues te nenshkruar (me poshte i quajtur "AKTI THEMELUES") nga themeluesit e saj si vijon :

1 - Zotit GIOVANNI TELESCA, shtetas italian, i datelindjes 29.03.1954, lindur ne Potenza dhe banues po aty ne adresen "Via Poggio Cavallo nr. 124", me Pasaporte nr. 2586618K,

dhe

2 - Zotit ITALO GIGANTE, shtetas italian, i datelindjes 18-12-1953, banues ne Ruoti-P2 - ITALY, me Pasaporte nr. 389675C,

(me poshte te quajtur bashkerisht ose vecamas "ORTAKE").

ORTAKET jane marre vesh qe, pervec sa eshte parashikuar ne AKTIN THEMELUES, rregullat e marredhenieve dhe te veprimtarise se SHOQERISE do te parashikohen nga ky

STATUT i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin

"ALBA BETON" Sh.p.k.

T I T U L L I \_ 1

Emertimi - Vula - Qendra - Kohezgjatja - Objekti

Neni 1 - EMERTIMI I SHOQERISE

SHOQERIA do te kete emertimin: "ALBA BETON" Sh.p.k.

Neni 2 - VULA DHE PUBLIKIMET E SHOQERISE

SHOQERIA ka VULEN e saj, permabjtja e se ciles do te jete si vijon: "ALBA BETON" Sh.p.k. .

Te gjitha aktet dhc dokumentat qe do te nxjerre SHOQERIA drejtuar te treteve ose publikut si p.sh. letra, fatura, lajmerime e publikime te ndryshme duhet te tregojne qarte e lexueshem emertimin e SHOQERISE dhe pas tij fjalet " shoqeri me perpjegjesi te kufizuar" ose " sh.p.k. " si dhe kapitalin e saj dhe emrat e Administratoreve te SHOQERISE.

Neni 3 - QENDRA E SHOQERISE - VENDBANIMI I ORTAKEVE

Qendra e SHOQERISE ndodhet ne TIRANE ne adresen (Bul ZHAN D'ARK Pall Shalvale nr. 143 c/o Zyre Avokatore "SADUSHI & DVORANI").

*Tekfess / reces* , Rr. "Arkitekt Sinan", Foggia 15

Poll. 220/L, nr. 7  
Tirane

*J. B. J. B.*

asistences dhe konsulences teknike, ligjore dhe te menaxhimit te veprimtarive te cdo lloji dhe ne vecanti ne fushat te cilat kane lidhje me objektin e veprimtarise se SHOQERISE.

5.5. SHOQERIA mund te ushtroje edhe veprimtarine e perfaqesimit, te ndermjetesimit apo te agjensise per persona fizike apo juridike, publike, shteterore apo private, vendas apo te huaj.

5.6. SHOQERIA mund te ushtroje veprimtari te tjera tregtare dhe gjithashtu, mund te jape ose te perfitoje leasing, te gjitha keto mbi pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, makineri, pajisje te cfaredo lloji dhe gjithashtu, mund te kryeje cdo lloj veprimi tjeter me pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, veprime finaciare duke perfshire ketu edhe factoring, tregtare te gjitha keto te quajtura te nevojshme dhe te dobishme per realizimin e qellimeve te objektit te veprimtarise se SHOQERISE.

5.7. SHOQERIA ka te gjitha te drejtat per te marre pjesë ne fitimet dhe /ose ne shoqeri te tjera te se drejtes shqiptare ose te shteteve te tjera dhe te themeloje shoqeri te tjera me persona fizike ose juridike, publike ose private, vendas ose te huaj.

#### Neni 6 - PERGJEGJESIA E SHOQERISE

SHOQERIA pergjigjet kundrejt te treteve vetem me pasurite e saj dhe, ne asnje rast, ajo nuk pergjigjet per detyrimet e marra persiper nga ORTAKET dhe as keta te fundit nuk perballojne detyrimet dhe humbjet e SHOQERISE pertej kufirit te vlefte se kuotes se pjesmarrjes se tyre ne kapitalin themeltar te saj.

SHOQERIA nuk pergjigjet per detyrimet e shtetit shqiptar dhc anasjelltas.

#### Neni 7 - E DREJTA PER INFORMACION

Secili ORTAK ka te drekte te kerkoje e te marre informacion prane organeve kompetente te SHOQERISE lidhur me ecurine e veprimtarise, administrimin dhe gjendjen e financave te saj.

#### Neni 8 - CILESIA E ORTAKUT. HUMBJA E TIJ

Cilesia e ORTAKUT vetekupton konsiderimin e qendres se SHOQERISE edhe si adrese dhe vendodhje te ORTAKUT si edhe pranimin pa asnje kusht te dispozitave te AKTIT THEMELUES, te STATUTIT, te vendimeve te Asamblese se Ortakeve, edhe sikur dispozita te tilli te kene hyre ne fuqi perpara fitimit te cilesise se ORTAKUT.

#### T I T U L I 2 Kapitali themeltar - Transferimi i pjeseve te tij

#### Neni 9 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i SHOQERISE ne castin e themelimit te saj eshte ne Leke 100.000 (njeqindmije), shume kjo e derdhur dhe depozituar per efekt te ligjit ne degen e Tiranes te Bankes se Kursimeve.

*Tefecan Fecova*  
*Hala Jona*

Trashegimtaret e ORTAKUT te vdekur e zevendesojne pa kufizime ne te drejta dhe detyrime trashegimlenesin e tyre te vdekur.

Ne rast te cedimit te kuotave nga ana e nje ORTAKU, ceduesi ka si detyrim te njoftoje ORTAKET e tjere, edhe ne adresen e treguar ne Itali, ne menyre qe ata te ushtrojne te drejten e parablerjes.

Ne oferten e cedimit, e cila u behet e ditur te gjithe ORTAKEVE me leter rekomande, ORTAKU cedues duhet te tregoje cmimin e cedimit dhe emerin e bleresit.

ORTAKET duhet te ushtrojne te drejten e parablerjes per te fituar ato kuota ose te njoftojne vullnetin e tyre nepermjet mbeledhjes e Asamblese se Ortakeve se heqin dore nga blerja e tyre, brenda tridhjete diteve nga njoftimi si me siper. Ne rast te ushtrimit te se drejtes se parablerjes ORTAKET i blejne kuotat qe cedohen ne proporcione pjesmarrjen e tyre ne SHOQERI.

Cedimet e kryera te treteve pa respektuar kriteret e treguara me siper ne kete nen ose me nje cmim me te uict nga ai i kerkuar nga ceduesi ORTAKEVE, jane te pavlefshme (nul) dhe nuk do te sjellin pasoje kundrejt ORTAKEVE dhe SHOQUERISE; pervec sa me siper do te zbatohen te drejtat e ORTAKVE per te blerc keto kuota me cmimin e ulet te paguar nga personi i trete.

#### Neni 12 - OPERACIONET FINANCIARE

SHOQUERIA ka te drejten e kerkimit dhe pranimit te burimeve te financimit apo kredive, hua etj. duke iu drejtar bankave dhe instituteve financiare qe e gezojne te drejten e financimit dhe kreditimit.

#### Neni 13 - BLERJET E SHOQUERISE

SHOQUERIA disponon dhe gezon pasurite e saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e themelimit te saj.

SHOQUERIA ka te drejten e blerjes dhe administrimit te pasurive te cdo lloji e natyre si dhe te jape garanci si mjet sigurimi mbi pasurite e saj per perm bushjen e detyrimeve qe merr persiper kundrejt te treteve.

#### T I T U L L I 3

#### Financat e SHOQUERISE - Bilanci

#### Neni 14 - BILANCI DHE FONDET E SHOQUERISE

SHOQUERIA per ushtrimin e aktivitetit te saj krijon fondet e nevojshme si dhe fondin rezevre e fonde per zhvillim. Perberja, madhesia e tyre, burimet e krijimit, perdonimi e rregullimi i cdo fondi te vecante ne perputhje me rrethanat, interesat dhe objektin e veprimtarise se SHOQUERISE, vendosen nga Asamblea e Ortakeve dhe Administratoret e SHOQUERISE duke respektuar dispozitat perkatese ne fuqi.

SHOQUERIA disponon mjetet e saj financiare. Te gjitha detyrimet

*Tepuna e govor  
S. G. J. P. K.*

Per kryerjen e veprimeve perqatitore, te konsultimeve me shkrim midis ORTAKEVE, thirrjen dhe realizimin e suksesshem te mbledhjeve te Asamblese se Ortakeve, kujdesi per ecurine e tyre dhe barra bie mbi Administratoret e saj.

#### Neni 17 - KOMPETENCA TE ZAKONSHME DHE TE JASHTEZAKONSHME

Asamblea e Ortakeve vendos ne menyre te vecante :

- 1 - per miratimin e bilancit vjetor dhe te programit te veprimtarise se SHOQERISE per vitin e ardhshem;
- 2 - per emerimin e Administratoreve;
- 3 - per perdorimin e fitimit;
- 4 - per ndryshimin e dispozitave te STATUTIT dhe te AKTIT THEMELUES;
- 5 - per zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit themeltar te SHOQERISE;
- 6 - per zgjatjen e afatit, prishjen e parakohshme apo ndyshimin e formes se SHOQERISE;
- 7 - per emerimin e likujduesit ose likujduesve dhe percaktimin e te drejtave dhe kompetencave te tyre :

#### Neni 18 - MBLEDHJA E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asamblea e Ortakeve, e cila mund te mblidhet, ne qendren e SHOQERISE ose jashte saj, si brenda ashtu edhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, thirret se paku nje here ne vit, por jo me vone se 3 (tre) muaj nga perfundimi i vitit finanziar mbas njoftimeve me shkrim te cilat u dergohen cdo ORTAKU 15 (pesembedhjete) dite perpara dates se mbledhjes, me leter rekomande me lajmerim marrje, ne adresen e secilit ORTAK te treguar ne LIBRIN E ORTAKEVE.

Njoftimi me shkrim i siperpermendur, per te qene i vlefshem detyrimisht duhet te tregoje daten dhe oren e thirrjes ( me numra dhe germa), vendin e thirrjes te treguar pa asnje shkurtim, rendin e dites me specifikimet perkatese lidhur me ceshtjet qe do te shqyrtohen. Ceshtjet qe nuk tregohen ne rendin e dites nuk mund te shqyrtohen pervec se me marreveshje unanime te ORTAKEVE te pranishem me kushtin qe te perfaqesojne se paku tre te katertat e kapitalit themeltar te SHOQERISE.


Mbledhja e Asamblese se Ortakeve drejtohet nga Administratori me i moshuar dhe ne pamundesi, nga nje person i zgjedhur nga Asamblea e Ortakeve, me votimin e te pranishmeve.

Kryetari i Mbledhjes se Asambleso se Ortakeve emeron nga ana e tij nje sekretar qofte edhe jo ORTAK.

Vendimet e Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve vertetohen nga nje proces verbal i ncnshkruar nga Kryetari dhe Sekretari i saj.

Ne rastet e parashikuara nga ligji procesverbalet dhe vendimet do te redaktohen nga nje Noter i zgjedhur nga Kryetari i Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve.

Asamblea e Ortakeve mblidhet per here te pare dhe per heren e



#### Neni 22 - KOMPETENCA TE ADMINISTRATOREVE

Administratoret kujdesen dhe veprojne me fuqite dhe kompetencat me te gjera lidhur me drejtimin e SHOQERISE dhe, ne menyre me te posacme kane te drejtat e zbatimit dhe te realizimit te qellimeve dhe te objekteve te SHOQERISE, me perjashtim te atyre qe ne baze te ligjit, AKTIT THEMELUES, STATUTIT i takojne ne menyre taksative dhe esklusive Asamblese se Ortakeve.

#### Neni 23 - KOMPETENCAT TE ADMINISTRIMIT

Administratoreve, bashkerisht ose vec e vec u takojne ne menyre te vecante kompetencat si vijon :

- 1- te zbatojne vendimet e Asamblese se Ortakeve;
- 2- te organizojne punen per perm bushjen e objektit te SHOQERISE, duke relatuar ne Asamblene e Ortakeve;
- 3- te administrojne pasurine dhe mjetet e SHOQERISE, perfshire mjetet financiare, ne perputhje me dispozitat e STATUTIT, AKTIT THEMELUES, vendimet e Asamblese se Ortakeve ose ne aktet ligjore;
- 4- te drejtojne dhe te kontrollojne veprimtarine e filialeve, agjensive, perfaqesive, zyrave e te tjera si keto te themeluara nga SHOQERIA.
- 5- te lidhin kontrata te cfardo lloji e natyre ne emer dhe per llogari te SHOQERISE.
- 6- te bejne cdo pagese qe detyrohet SHOQERIA, te hapin ose mbylliin llogari bankare te SHOQERISE si edhe te depozitojne, terheqin ose tranferojne te holla nga keto llogari;
- 7 -te marrin dhe pushojne nga puna personelin e SHOQERISE dhe te nenshkruajne kontratat perkatese.

Administratoret jane pergjegjes ndaj SHOQERISE per detyrimet qe jane brenda kompetences se tyre ekskluzive.

#### Neni 24 - PERFAQESIMI DHE FIRMA E SHOQERISE

Të drejten e Firmes dhe te perfaqesimit te SHOQERISE edhe perpara gjykates e kanc, bashkerisht ose vec e vec, te dy Administratoret e saj.

Administratoret kane te drejte te delegojne te drejten e firmes duke emeruar nje ose me shume prokuries te posacem, me perjashtim te se drejtes per te emeruar prokuries te per gjithshem.

#### Neni 25 - KONTROLLI I AKTIVITETIT EKONOMIKO-FINANCIAR

Per kontrollin e veprimtarise se SHOQERISE, Asamblea e Ortakeve emeron nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar.

Keta eksperte kontabel, emerohen per cdo vit ushtrimor, jane te riemerueshem dhe nuk duhet te jene punonjes te SHOQERISE ose te filialeve, agjensive, perfaqesive te saj.

#### Neni 26 - MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes ndermjet SHOQERISE, filialeve e agjensive

*Tefeqe Leoden  
Babu Gjonik*



- 11 -

dy arbitrat e emeruar. Vetem ne rast te mungeses se marreveshjes per caktimin e ekspertit te katert, ky i fundit do te emerohet nga Kryetari i Dhomes te Avokateve te Tiranes me kerkesen e njeres pale.

Kolegji i Arbitrave si mesipcr duhet te dorezoje vendimin e zgjidhjes se mosmarreveshjes brenda tridhjete diteve nga emerimi i tyre.

Vendimi merret me shumice votash dhe pa formalitet te vecanta. Ne rast barazie votash vendos vota e Kryetarit te Kolegjit te Arbitrave treguar ne paragrafin e pare te ketij neni. Ky vendim eshte i detyrueshem per palet. Ne rast te kundert dhe mospajtimi te metejshem zgjidhja e mosmarreveshjes i paraqitet Gjykates se rrethit Tirane.

#### Neni 31 - DISPOZITA TE ZBATUESHME PER SHOQERINE

Marredheniet ne SHOQERI rregullohen nga dispozitat e AKTIT THEMELUES, STATUTIT, Vendimet e Asamblese se Ortakeve dhe te Administratoreve dhe qe jane ne perputhje me ligjin. Per marredhenie dhe probleme qe nuk jane trajtuar shprehimisht ne aktet e mesiperme, do te zbatohen dispozitat e akteve ligjore dhe nenligjore te fushes tregtare ose ne perjithesi.

#### Neni 32 - DISPOZITE E FUNDIT

Ky STATUT hyn ne fuqi diten e rregjistrimit te SHOQERISE ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit te Tiranes.

Ky STATUT u hartua ne 12 faqe te shtypura ne kompiuter dhc pjeserisht me dore nga nje person i besuar nga Noteri ne gjuhen shqipe ne pose origjinal. Dy nga origjinali i mbani SHOQERIA dhe te tjerat depozitohen perkatesisht prane Gjykates, Noterit dhe organit kompetent tativor.

ORTAKET pasi e lexuan, e kuptuan dhe e pranuan kete STATUT, e nenshkruejne ate sot me daten \_\_\_ Shtator 1996 (nentedhjete e gjashte) ne prani te Noterit dhe qe nga ky cast ky STATUT eshte i detyrueshem per ORTAKET.

O R T A K E T      E      S H O Q E R I S E :

GIOVANNI TELESCA  
*T. Telesca*

ITALO GIGANTE  
*I. Gigante*